


Č



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo



AGJENCIA KUNDËR KORRUPTIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLICA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KUNDËR KORRUPTIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	24.08.2018
REFERENC-Ë:	AKK-DPKPP/03-03-2430/18
PËR/ZA/TO:	<p>z. Shaban TAFA, Shef i Zyrës së Prokurim, Ministria për Komunitet dhe Kthim</p> <p>z. Nenad STOJČETOVIĆ Sekretar i Përgjithshëm, Ministria për Komunitet dhe Kthim</p>
PËRMES/PREKO/THROUGH:	<p>z. Shaip HAVOLLI, Drejtësor i Agjencisë kundër Korruptionit</p> <p><i>Depot.</i> <i>A</i></p>
NGA/OD/FROM:	Afrim ATASHI, Drejtësor i Departamentit për Parandalimin e Korruptionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin me titull "Ndërtimi i qendrës kryesore të mjekësisë familjare (QKMF) KK Ranilug".

Inderuari z. Tafa,

Në mbështetje të nenit 142 (par. 3) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 (par. 1, nënpar. 1.1.) dhe 21 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korruptionit, nenit 9 (par. 1, nënpar. 1.5.), 16 (par. 2) dhe 21 (par. 3) të Ligjit nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, nenit 2 par.3 dhe të nenit 10 të Rregullores nr. 01/2018 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores nr. 01/2014 dhe Rregullores nr. 01/2017, së Punës së Agjencisë kundër Korruptionit, lidhur me tenderin me titull: "Ndërtimi i qendrës kryesore të mjekësisë familjare (QKMF) KK Ranilug ", me numër të prokurimit: 211/18/5821/521, dhe me nr. të brendshëm:MKK-211/18/032/521, Agjencia kundër Korruptionit ofron këtë:

OPINION

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të evidentuara në lidhje me tenderin: "Ndërtimi i qendrës kryesore të mjekësisë familjare (QKMF) KK Ranilug ", me numër të prokurimit: 211/18/5821/521, dhe me nr. të brendshëm:MKK-211/18/032/521, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit për prokurimin publik nr.04-L/042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr.04/L -237, Ligjin nr. 05/L-068 dhe Ligjin nr. 05/L-092.

Arsyetimi

Agjencia kundër Korrupsionit (në tekstin e mëtejmi Agjencia), duke vepruar sipas detyrës zyrtare pas kontrollimit të njostimeve për konratë që ka bërë në Sistemin elektronik të Prokurimit, me datë 16 gusht 2018, ka nxjerrë vendim me numër protokoll: AKK-03-03-2430/18, për fillimin e procedurës për trajtimin e rastit në lidhje me aktivitetin e prokurimit publik me titull: "Ndërtimi i qendrës kryesore të mjekësisë familjare (QKMF) KK Ranilug", me numër të prokurimit: 211/18/5821/521, dhe me nr. të brendshëm: MKK-211/18/032/521, i iniciuar nga Autoriteti kontraktues Ministria për Komunitet dhe Kthim.

Agjencia në bazë të dokumenteve të nxjerra nga Sistemi Elektronik i Prokurimit ka analizuar njostimin për konratë dhe dosjen e tenderit, ku ka konstatuar se autoriteti kontraktues, për këtë aktivitet të prokurimit ka paraparë procedurën e hapur, konratë publike, të llojit punë, me vlerë të mesme të parashikuar prej 299,742.27 €.



Agjencia në bazë të dokumenteve të nxjerra nga platforma ***E-Prokurimi*** ka vërejtur se në njostimin për konratë dhe dosjen e tenderit, në nenin III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional është kërkuar: "Lista e punëtoreve teknik" ndërsa tek dëshmia dokumentare është kërkuar "Kompania duhet të sjell listën e së paku 20 punëtoreve original nga ATK për tre muajt e fundit nga data e publikimit të njofimit për konratë".

Agjencia kundër Korrupsionit konsideron se një kërkesë e tillë e vendosur nga autoriteti kontraktues është ne kundërshtim me nenin 69 paragrafi 6.4 të Ligjit në fuqi për prokurimin publik, sipas nenit të lartë cekur autoriteti kontraktues mund të kërkojë minimumin e mesatares së fuqisë punëtore dhe stafit menaxherial për secilin nga 3 vitet e fundit, ku si dëshmi mund të kërkojë një deklaratë apo raport përfshinë mesatare punëtore dhe numrin mesatar të personelit udhëheqës të operatorit ekonomik për secilin nga tri vitet e kaluara.

Duke u bazuar në nenin 18.4 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik parashihet që në dosjen e tenderit Autoriteti kontraktues do të deklaron të gjitha informatat relevante për konratës në fjalë që operatorët ekonomik të interesuar duhet të dinë përgatitjen e tenderëve pa kërkuar informata shtesë. Informata të tilla do të përfshijnë të gjitha specifikimet, kërkesat, kriteret, afatet kohore, metodologjitet, kushtet e konratës, vizitat në lokacion ose takime para-tenderuese etj. të lidhura me procedurat e dhënies së konratës. Çdo fjali në dosjen e tenderit do të përpilohet mirë, pasi që dosja e tenderit është materiali themelor, në bazë të cilit operatorët ekonomik do të krijojnë tenderët e tyre. Dosja e tenderit do të përgatitet në mënyrë të tillë, që si rregull parimor të mos ketë nevojë për informata sqaruese shtesë. Veçanërisht, Autoriteti kontraktues duhet të ketë parasysh, kur përgatitet dosja e tenderit, që mos të ketë komunikime, diskutime ose negocime në mes të autoritetit kontraktues dhe tenderuesve. Kërkesat e përektuara në dosjen e tenderit dhe në njostimin për konratë duhet të janë identike.

Agjenci kundër Korrupsion, konsideron se veprimet e autoritetit kontraktues bien ndesh me nenin 7 Barazia në trajtim dhe jo-diskriminimi, nenin 27 Dosja e tenderit si dhe nenin 69 Aftësitë teknike dhe profesionale të Ligjit për Prokurim Publik Nr.04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, nenin 18.4 dhe nenin 26.8 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik.

Konsiderojmë se shkeljet e tilla nuk duhet lejuar ne aktivitete të prokurimit, andaj Agjencia kundër Korrupsion rekomandon që të evitohen këto shkelje, përmes njoftimit standard për informata shtesë dhe përmirësimin e gabimeve, duke i njoftuar te gjithë operatorët ekonomik të cilët e kanë tërhequr dosjen e tenderit.

Po ashtu ju njoftojmë se lidhur me këto të gjetura do të njoftohet Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik – KRPP.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !

